

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Misin Frangu dhe procesmbajtësen Arbelinda Tahiri, në çështjen juridike, sipas padisë së paditësit [REDACTED] nga Ferizaj [REDACTED], [REDACTED], të cilën me autorizim e përfaqëson av. Ilmi Qorri nga Ferizaj, kundër të paditurës [REDACTED] të cilën me autorizim e përfaqëson Sami Vranovci, për çështjen e pagesave përcjellëse dhe jubilarë, në prezencën e paditëses dhe të përfaqësuesit të të paditurës, në shqyrtimin e mbajtur me datë 05.07.2017, merr këtë:

### AKT GJYKIM

**I.APROVOHET** në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditëses [REDACTED] nga [REDACTED]  
Rr. [REDACTED]

**II.DETYROHET** e paditura [REDACTED], që paditësit në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi prej 1.408.05 €, dhe tri pagave jubilarë në lartësi prej 1.408.05 €, e që shuma e përgjithshme i bie **2.816.10 € (dy mijë e katërqind e tetë euro, e nëntdhjetë cent)**, të cilën shumë e paditura është obliguar t'ia paguaj paditësit, së bashku me kamatën, e cila do të llogaritet sipas lartësisë që llogarisin bankat për deponimet e rëndomta të qytetareve, të afatizuara për periudhë një vjeçare, pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e kësaj procedurë në shumë prej **135.00 €**, si dhe 104 € për përpilimine padisë, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

**III.OBLIGOHET** paditësi që të paguaj shpenzimet për taksën gjyqësore 15 € dhe atë për aktgjykim shumë 40 €, bazuar në nenin 12.1 të UA nr.01/2017 të KGJK-së, për unifikimin e taksave gjyqësore.

**III.REFUZOHET**, kërkesa e paditësit për shumën e kërkuar prej 338.04 €, si e pa bazuar.

### A r s y e t i m i

Paditësja me datë 03.02.2016, ka parashtruar padi kundër të paditurës lidhur me pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe pagesën e tri pagave jubilarë.

Përfaqësuesi i të paditëses me padi dhe parashtrimet në seancat e mbajtura ka bërë precizimin e kërkesëpadisë sepse në padi ka kërkuar dy paga përcjellëse, ndërsa tani kërkon tri paga përcjellëse. Ka deklaruar se mbetet në tërësi si në padi dhe precizimin e kërkesëpadisë duke u bazuar në GZ të Kosovës nr.38 të datës 18.06.2014 në bazë të nenit 53 është parapar që nënpunësit civil t'u i njihet njihet e drejta në tri paga përcjellëse pas pensionimit si dhe konform nenit 52 par.1 pika 1 dhe 2, të njejtës i takojn edhe tri paga jubilarë, të cilat jepen për qdo 10 vite, në arsim, andaj ka kërkuar nga Gjykata që të shtjelloj provat e prezantuara dhe të njejtës të i njihet-paditësit tri paga përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri paga jubilarë. Tri paga përcjellëse me rastin e pensionimit në shumë prej 1577,25 € dhe tri paga jubilarë në shumë prej 1577,25 €, në shumë të përgjithëshme prej 3154,50 €, janë të bazuara në kontratën kolektive në bazë të nenit 36 par 9 pika 9.1 dhe 9.2 dhe nenit 36 par 10. Punëtorët antar të SBASHK-ut që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave mujore sipas mesatares së tri pagave të fundit për puntorin, nëherit i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës sipas tarifës së OAK-së, andaj nga të theksuarat më lartë Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

I autorizuari i të paditurës ka deklaruar se mbetet në tërësi në përgjigjen në padi duke kontestuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazë juridikë ligjore në bazë të Ligjit të punës, Ligjit mbi arsimin para universitar Ligjin mbi arsimin të komunave të Kosovës dhe aktëve të tjera nën ligjore, askund nuk parashihen dhe nuk është sanksionuar çështja lidhur me kompenzimin e të ardhurave personale me rastin e pensionimit, Sa u përket pagave jubilarë konstatojmë se kjo çështje është rregulluar konform nenit 36 par.9 pika 5 të kontratës kolektive nr.21 e datës 11.04.2014 e lidhur ndërmjet MASHT dhe SBASHK-ut, p e ku është paraparë afati prekluziv se kur duhet të realizohet kjo e drejtë. Paditësja ka pas të drejtë brenda 30 ditë pasi ka mbushur përvojën për paga jubilarë. Paditësja në padin e saj dhe në parashtrirat për rregullimin e padisë në asnjë mënyr nuk e ka precizuar se kur i ka mbushur 10 vite, 20 vite dhe 30 vite të përvojës së punës. Këtë të drejtë nuk e ka realizuar kështu që në bazë ligjore është parashkruar dhe ka humbur të drejtën ligjore për realizimin e pagave jubilarë, kurse sa i përket pagave përcjellëse ashtu edhe pagave jubilarë paditësi nuk ka paraqitur në kërkesë padinë e tij sekur ka filluar të paguaj shumën për 0.5% të pagës bazë në llogari të SBASHK-ut dhe kur ka filluar SBASHK-u të kërkoj përmbushjen e këtij detyrimi vullnetar nga punëtorët arsimor gjegjësisht nga paditësja.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes kontestimore, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 8.1 të LPK-së, gjykata ka administruar provat si vijojnë: Kontrata e punës me nr.protokolli 41 e daës. 01.03.2015, Libreza e punës me nr.6762/75, në emër të Raif Qukofcit; Shkresa zyrtare nr.52 e datës 18.01.2016, Shkresa zyrtare nr.370/2 e dt.31.05.2017, regjistri i 3 pagave të fundit të Raif Qukovci.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mesë palëve se paditësja për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension, e paditura nuk e ka kontestuar pretendimet në padi nga ana e paditëses se ka përvojën e punës mbi 40 vjet.

Me leximin e Librezës së punës Gjykata ka konstatuar se paditësja ka punuar te e paditura nga data 10.03.1975, e deri në momentin e pensionimit me datë 08.01.2015. Me leximin e Shkresës zyrtare nr.52 të datës 18.01.2016, Gjykata ka konstatuar se paditëses i është refuzuar kërkesa për kompensimin e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit; Me leximin e Shkresës zyrtare me nr. protokollit: 370/2 e datës 31.05.2017, Gjykata ka konstatuar se paditësja në tre muajt e fundit ka realizuar mesataren e pagës në shumë prej 1.408.05 €.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësis për tri pagat jubilarë në shumën prej 1.408.05 si dhe tri pagave përcjellëse shumën prej 1.408.05 nga shkresa zyrtare të cilën e ka dorëzuar në Gjykate e paditura me nr. protokollit nr.370/2 të dt.31.05.2017, ku vërtetohet se paditësja në muajt e fundit para daljes në pension dhe atë në korrik ka pranuar pagën mujore 469.35 € në muajin nëntor, ka pranuar 430.83 € në muajin dhjetor dhe ka pranuar 469.35 € është vërtetuar se paga mujore për muajin janar ka qenë 469.35 €.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadiisë është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 53 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët ndërsa zbatohet prej 01 Janar të viti 2015 , ndërsa me nenin 51 të kësaj kontrate zbatohet në rastin ku ka implikime financiare.

Me rastin e refuzimit të shumës së kërkuar nga ana e paditësit, shumën prej 338.04 €, e ka zbritur nga shuma e kërkuar nga ana e paditësit prej 3154.50 €, gjykata vendim e ka mbështetur se pagat mujore të paditësi për tre muajt e fundit ka qenë 469.35, 469.35, dhe 469.35 €, shuma e përgjithshme për tri paga përcjellëse dhe tri paga jubilarë 2.816.10 €, duke u mbështetur në shkresën zyrtare me nr.370/6 31.05.2017, lëshuar nga Drejtoria e Arsimit e Komunes së Ferizaj.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontratë për faktin se me rastin e daljes së tij në pension kontrata kolektive ka qenë në fuqi e cila nuk është kontestuar nga ana e të paditurës.

Në nenin 36 par. 9 pika 9.1 dhe 9.23 të kontratës kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës në punë të punëdhënësi, i fundit në vlerë të një page bazë, për 20 vite të përvojës në punë të punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy pagave bazë dhe për 30 vite të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë prej tri pagave bazë, punëdhënësi i fundit është ai që e paguan shpërblimin jubilar, të shpërblimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension paditëses brenda 1 muaji sipas nenit 36 par. 9 pika 9.5 të ia paguajë tri paga jubilarë pasi që i ka plotësuar këto kushte, pasi ka pasur përvojën e punës mbi 30 vjeçare dhe ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as për të paraqitur ndonjë kërkesë çoftë gojore apo me shkrim të paditurës.

Kurse neni 36 par. 10 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesat përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, e në rastin konkret Gjykata ka marrë parasysh që tri pagat e fundit të punëmarrësit kanë qenë 469.35 €, 469.35 dhe 469.35 dhe nuk ka pas ndryshim në tre muajt e fundit para daljes në pension dhe me rastin e vendosjes është bazuar në këtë fakt se ka pasur ndryshime në pagat si janë shënuar me lartësi dhe në bazë të tri pagave të fundit që të merret një mesatare e ka marrë për bazë tri pagat e fundit që ka ndodhë në rastin konkret rezulton se paditësja ka pasur pagën mujore tek e paditura shumën prej 469.35 €, 469.35 €, dhe 469.35 €.

Pretendimet e përfaqësuesit të paditurës se paditësja kërkesën për kompensimin e pagave përcjellëse duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka pasur fonde të veçanta që ti përmbushë këto detyrime, këto pretendime për Gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të gjitha DKA, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësi.

Kurse sa i përket asaj që pagat jubilarë janë të parashkruara pasi që në nenin 36 par. 9 pika 9.5 kjo bëhet brenda një muaji për çdo 10 vite, ku paditësja ka bërë dhe në atë kohë është dashur të realizohen këto të drejta.

Gjykata konsideron se një pretendim i tillë është i pa bazuar se në rastin konkret nuk kemi parashkrim, pasi që sipas nenit 36 par. 9, thuhet qartë se për të përfituar paga jubilarë punëtorët e SBSHK-ut, në rastin konkret paditësja duhet që fillimisht të dali në pension që të përfitojë shpërblimin jubilar e jo në kohën sa është në marrëdhënie pune, respektivisht kur i ka bërë 10 vite përvojë pune, 20 apo 30, siç parashihet me këtë nen 36 par. 9 pika 9.1, 9.2 dhe 9.3.

Se pretendimi i përfaqësuesit është i pa bazuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me institutin e parashkrimit pasi që kjo është rregulluar me dispozitat ligjore të ligjit të punës nr. Ligji 03/L-212 dhe çështja e parashkrimit është e rregulluar me nenin 87 dhe ky afat nuk mundet me u ndryshu me marrëveshje në mes të palëve, se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me zbatimin e institutit të parashkrimit është edhe për faktin se në nenin 36 par. 9 pika 9.4, thuhet decidivisht se punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpenzimin jubilar, e që në rastin konkret rezulton se paditësja ka dal në pension tek e paditura dhe kjo ka për obligim që të i paguajë paditëses 3 paga jubilarë.

Në bazë të nenit 452 par 1 të LPK-së e paditura është obliguar ti paguaj paditëses shpenzimet e kësaj procedurë në shumë prej **135.00 €**, si dhe taksën gjyqësore në shum 40 € për aktgjykim ne shum prej 40 € bazuar në nenin 12.1 te UA nr. 1/2017 të KGJK-së, për unifikimin e taksave gjyqësore.


Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**

**C.nr.99/16 date 05.07.2017**

**Gjyqtari,**

**Misin Frangu**




**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC

*CA nr. 4234/17*



Më 16.04 2018  
Dana



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

VENDIMI ËSHTË I EKZEKUTUESHËM  
ODLUKA JE IZVRŠNA

Më dt. 10.05.2018 vit.  
Dana god.  
Punëtori i autorizuar  
Ovlaščeni radnik

